

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5497
E premte, 8 qershor 2018
çmimi 0.40 €

Veseli merr përkrahjen e Austrisë për liberalizimin e vizave

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

A MUND TË MERRET KJO FUSHATË TURISTIKE SI LOBIM, APO NDËRKOMBËTARISHT DO TË NOTERIZOHET SI DËSHTIM DHE DISKREDITIM? F. 11

BEHXHET
SH. SHALA-
BAJGORA



LIGJI PËR ARSIMTARËT E VITEVE '90-TA PËRPLAS KOSOVËN ME FMN-në F. 5

POLICISË DHE FORENZIKËS I DORËZOHEN PAJISJE PËR KONTROLLIN E ARMËVE F. 7

EKONOMI

FILLON VLERËSIMI I 1 642 PROJEKTEVE BUJQËSORE F. 9

KOSOVA, PJESË E SHËNIMIT TË 'DITËS BOTËRORE TË KONSULENCËS' F. 8

KULTURË

EPOKA E GJERGJ KASTRIOTIT, HISTORI E LUFTËRAVE PËR RUAJTJEN E IDENTITETIT KOMBËTAR F. 13

SPORT

'DUGI', AFËR DUKAGJINIT F. 14

KOSOVA NGRIHET 11 POZITA NË RENDITJEN E FIFA-S, BIE SHQIPËRIA F. 14



FLET PËR "EPOKËN E RE", QËNDRON KASTRATI F. 4-5

Jam optimist për të ardhmen e PSD-së

Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), njëherësh kryetar i Kamenicës, Qëndron Kastrati, është shprehur i sigurt në të ardhmen politike të këtij subjekti politik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka thënë se garanci për këtë është vullneti i anëtarëve dhe programi i PSD-së. Sipas Kastratit, për një kohë të shkurtër PSD-ja do të konsolidohet fuqishëm në çdo degë në nivel vendi. Duke folur për qeverisjen në Komunën e Kamenicës, Kastrati ka thënë se duke ndryshuar formën e funksionimit të brendshëm do të mundësojnë kursim më të madh të shpenzimeve të ashtuquajtura të luksit dhe riorientim të atyre mjeteve në fusha më të nevojshme për qytetarët. "Jam ihtar i bashkëpunimit për programe e projekte në të mirë të qytetarëve dhe nuk operoj me inate në politikë. Pres një bashkëpunim të tillë edhe nga subjektet e tjera, sidomos nga Lëvizja Vetëvendosje", ka thënë Kastrati

Kosova këtë vit i ka shanset më të mira për t'u anëtarësuar në INTERPOL

Ekspertët e sigurisë, Nuredin Ibishi dhe Behar Selimi, u kanë bërë thirrje institucioneve ta vazhdojnë punën dhe lobimin për anëtarësimin e vendit në INTERPOL. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se këtë vit shteti i Kosovës i ka shanset më të mira për t'u bërë pjesë

e kësaj organizate të rëndësishme. Sipas tyre, anëtarësimi i Kosovës në INTERPOL është në interes të kësaj organizate dhe të shteteve anëtare të saj. Ibishi e Selimi i kanë quajtur të kota përpjekjet e Serbisë për ta penguar Kosovën në këtë proces F. 3



Limaj: Nisma po angazhohet për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë të enjten se Nisma anekënd Kosovës është kthyer në një subjekt shprese dhe mundësie

për qytetarët. Në Kuvendin e Punës së Nismës në Mitrovicë, Limaj ka theksuar se energjitë i kanë drejtuar për zgjedhjen e problemeve të qytetarëve F. 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Pritren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Franca, Holanda dhe Danimarka frenojnë hapjen e negociatave me Shqipërinë

BERLIN, 7 QERSHOR - Franca, Holanda dhe Danimarka që po e frenojnë aktualisht hapjen e negociatave të anëtarësimit. Gjermania është më shumë pro hapjes së tyre. Sipas informacioneve të agjencisë "Reuters" për Gjermaninë, janë tri vende momentalisht që e bëjnë të pasigurt hapjen e negociatave të anëtarësimit të BE-së me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Ato janë Franca, Holanda dhe Danimarka. Prandaj është e paqartë nëse Komisioni Evropian do ta japë dritën e gjelbër në samitin e BE-së në fund të

qershorit, thuhet jo vetëm nga qarqet e Komisionit Evropian, por edhe të Qeverisë gjermane. Brenda Berlinit ka zëra kritikë për qëndrimin e Macronit se nuk po e dallon rëndësinë gjeostrategjike të Ballkanit Perëndimor për stabilitetin e Evropës, vëren "Reuters". Për Macronin nuk ka interes aq zgjerimi sesa forcimi i bashkëpunimit brenda BE-së dhe vendeve të eurozonës. Ndërsa në Bruksel thuhet se "Macroni ka ndjesinë, se do t'ua hapte krahun djathtistëve në politikë, sepse për Shqipërinë

mendohet menjëherë për kriminalitetin e organizuar", shkruan "Reuters". Edhe Qeveria holandeze e argumenton qëndrimin e saj kundër menjëherë me frikën e brendshme.

Komisioni Evropian kërkon hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë, sepse dy vendet i kanë përmbushur formalisht kriteret dhe BE-ja duhet t'i qëndrojë fjalës së saj.

Por edhe në Gjermani ka dyshime lidhur me hapjen e negociatave brenda Unionit konservator. "Reuters" shkruan



se kancelarja gjermane Angela Merkel dhe ministri i Jashtëm, Heiko Mass, socialdemokrat, janë për hapjen e negociatave.

Nga qarqet qeveritare thuhet se bëhet fjalë për fillimin dhe jo për mbylljen e negociatave që zgjasin me vite.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është pritur në një takim të veçantë nga kryetari i Parlamentit austriak, Wolfgang Sobotka

Veseli merr përkrahjen e Austrisë për liberalizimin e vizave

Kryeparlamentari austriak Wolfgang Sobotka ka thënë se Austria e përkrah gjithmonë Kosovën edhe në procesin e liberalizimit të vizave dhe nëse vlerësohet se janë përmbushur kriteret, ne jemi të gatshëm të vazhdojmë këtë përkrahje për heqjen e vizave



Vjenë të kryetarit Veseli dhe delegacionit që e shoqëron, e konsideroi një mundësi për të kontribuar më shumë në forcimin dhe avancimin e mëtejshëm të marrëdhënieve që tashmë të dy shtetet dhe parlamentet respektive kultivojnë ndërmjet tyre. Ai vlerësoi lart hapat zhvillimorë që ka bërë Kosova në të gjithë fushat, ndërsa shprehu gatishmërinë e shtetit të tij për ta vazhduar mbështetjen për Kosovën edhe në të ardhmen. "Austria e përkrahë Kosovën në rrugën e saj drejt integritetit evropian. Austria e përkrah gjithmonë Kosovën edhe në procesin e liberalizimit të vizave dhe nëse vlerësohet se janë përmbushur kriteret, ne jemi të gatshëm ta vazhdojmë këtë përkrahje për heqjen e vizave", tha kryeparlamentari Sobotka. Turneun lobues për liberalizimin e vizave, kryeparlamentari Veseli e ka nisur në Austri, pasi ky shtet mik i Kosovës nga data 1 korrik do ta marrë kryesimin e Këshillit Evropian.

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në kuadër të vizitës zyrtare në Austri, është pritur të enjten në një takim të veçantë nga kryetari i Parlamentit austriak, Wolfgang Sobotka.

Kryeparlamentari Veseli falënderoi homologun e tij për mbështetjen e vazhdueshme ushtarake, politike e ekonomike të Austrisë për Kosovën në të gjitha fazat, sidomos vitet e fundit në aspektin e zgjerimit të njohjes ndërkombëtare dhe në procesin e integritetit evropian. Në këtë funksion, kryeparlamentari Veseli kërkoi mbështetjen e nevojshme të Austrisë për liberalizimin e vizave. "Kemi nevojë për përkrahjen e Austrisë në rrugën tonë drejt

integritetit evropian. Republika e Kosovës i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave dhe qytetarët tanë meritojnë të lëvizin lirshëm në Evropë. Ne presim që në fund të këtij viti qytetarët tanë të mund të lëvizin pa viza në Zonën Shengen", tha kryeparlamentari Veseli.

Veseli e njoftoi kryeparlamentarin austriak edhe për zhvillimet aktuale në Kosovë, hapat që po ndërmarrin institucionet në fushën e zhvillimit ekonomik dhe angazhimet në kuadër të procesit të integritetit evropian e të anëtarësimit në organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Kryetari i Parlamentit të Austrisë, Wolfgang Sobotka, vizitën në

Ambasadori Lu takon ministrin e Brendshëm Xhafaj

TIRANË, 7 QERSHOR - Ministria e Brendshme ka zbardhur takimin e ministrit Fatmir Xhafaj, i cili priti në zyrën e tij ambasadorin e ShBA-së në Tiranë, Donald Lu. Sipas ministrit, takimi u fokusua në zhvillimet e fundit në vend, veçanërisht në përpjekjet e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, në luftën kundër krimit të organizuar dhe paligjshmërisë.

Ministri Xhafaj e njohu

ambasadorin me situatën aktuale dhe veprimtarinë e Policisë së Shtetit në këtë luftë. Ambasadori amerikan vlerësoi punën dhe arritjet e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, duke theksuar se është shumë e rëndësishme që kjo e fundit të jetë e motivuar për të vijuar me vendosmëri luftën kundër krimit të organizuar.

Në këtë kontekst, ai shprehu mbështetjen e fortë të ShBA-së si dhe vendeve të tjera partnere,

për Ministrinë e Brendshme dhe ministrin Xhafaj, në gjithë përpjekjet e tyre për t'u dhënë qytetarëve më shumë rend e siguri. Ambasadori Lu inkurajoi ministrin Xhafaj dhe Policinë e Shtetit, për t'o vijuar edhe më me intensitet përpjekjet për më shumë rezultate në luftën kundër krimit të organizuar pasi kjo, sipas tij, është ajo çfarë qytetarët presin sot më shumë se çdo herë tjetër, nga Policia e Shtetit.



Kosova këtë vit i ka shanset më të mira për t'u anëtarësuar në INTERPOL



Ekspertët e sigurisë, Nuredin Ibishi dhe Behar Selimi, u kanë bërë thirrje institucioneve ta vazhdojnë punën dhe lobimin për anëtarësimin e vendit në INTERPOL. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se këtë vit shteti i Kosovës i ka shanset më të mira për t'u bërë pjesë e kësaj organizate të rëndësishme. Sipas tyre, anëtarësimi i Kosovës në INTERPOL është në interes të kësaj organizate dhe të shteteve anëtare të saj. Ibishi e Selimi i kanë quajtur të kota përpjekjet e Serbisë për ta penguar Kosovën në këtë proces

është koha e duhur të aplikohet, sepse këtë vit janë gjasat reale për ta anëtarësuar Kosovën në këtë organizatë", është shprehur Ibishi, duke shtuar se anëtarësimi i vendit në INTERPOL është në interes të të gjithëve. "Ne po jemi të hendikepuar pikërisht për shkak të mungesës së anëtarësimit. Ata çdoherë kërkojnë informacione që ne i bëjmë për shërbimet e policisë dhe të inteligjencës, mirëpo nuk marrim informacionin e duhur për lëvizjen e personave që janë të ndjekur dhe ky është një rrezik për sigurinë tonë, por edhe të rajonit. Për këtë arsye edhe ndërkombëtarët e kanë kuptuar, prandaj besoj se do të jenë në përkrahje të Kosovës, edhe pse përfundimisht vendimi varet prej vendeve anëtare të INTERPOL-it. Po të mos ishim tërhequr vitin e kaluar, sot Kosova do të ishte e anëtarësuar në INTERPOL. Mirëpo edhe tash janë shanset dhe relativisht mirë jemi në lobim, prandaj jam optimist se mund të kalojmë", ka deklaruar ai.

Ibishi ka thënë se nuk duhet dekurajuar nëse Serbia dhe disa vende të tjera llojnë kundër pranimin të Kosovës në këtë organizatë. Përkundrazi, sipas tij, duhet të jemi shumë më aktivë dhe të llojmë së bashku me shtetet që e shohin të nevojshëm anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL. "Nga Serbia nuk presim asnjë të mirë. Ajo po lobon për tërheqjen e njohjeve edhe tek shtetet që e kanë pranuar pavarësinë. Normalisht se ajo mund të bëjë përpjekje për ta penguar, por

Kosova duhet t'i shfrytëzojë shtetet mike që kanë ndikim te vendet e tjera, për arsye se edhe atyre u lehtësohet bashkëpunimi në rast se Kosova bëhet pjesë e INTERPOL-it", ka theksuar Ibishi.

Edhe njohësi tjetër i çështjeve të sigurisë dhe ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Behar Selimi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se këtë vit janë shtuar gjasat për anëtarësimin e vendit në INTERPOL. Sipas tij, tashmë është e qartë se anëtarësimi i Kosovës në këtë organizatë është në të mirën e të gjitha shteteve anëtare. "Gjasat kanë qenë të mira edhe vitin e kaluar, por për arsye se unë ende nuk i kam kuptuar është hequr dorë prej aplikimit. Por këtë vit besoj se gjasat për anëtarësim janë ende më të mira se në vitin e kaluar. Si duket është shtuar bashkëpunimi ndërmjet institucioneve tona, përkatësisht të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme. Po ashtu, është shtuar interesimi i shteteve anëtare të INTERPOL-it për shkak se e kanë të qartë se anëtarësimi i Kosovës në këtë organizatë është në të mirën e të gjitha shteteve anëtare", ka deklaruar Selimi. Sipas tij, INTERPOL-i në rast të mospranimin rrezikon të mos bashkëpunojë me Kosovën në fushën e luftimit të krimit me element ndërkombëtar. "Është në interes të INTERPOL-it për ta futur Kosovën në organizatë, në të kundërtën do të mbetet një vrimë shumë e keqe në Ballkan e cila edhe mund të mos

bashkëpunojë me INTERPOL-in në fushën e luftimit të krimit me element ndërkombëtar. Prandaj është dëm i madh për organizatën e INTERPOL-it mospranimi i Kosovës. E kam thënë dhe po e përsëris, se anëtarësimi i Kosovës në këtë organizatë më shumë është interes i INTERPOL-it dhe i shteteve veç e veç sesa i Kosovës. Por ne, megjithatë, po bashkëveprojmë dhe po bashkëpunojmë me INTERPOL-in edhe pa qenë anëtar, madje po bashkëpunojmë edhe më shumë se shtetet që janë anëtare", është shprehur Selimi, duke shtuar se, pavarësisht prej përpjekjeve të Serbisë për ta penguar janë rritur gjasat e Kosovës për t'u anëtarësuar në INTERPOL. "Përpjekjet e Serbisë për ta penguar anëtarësimin e Kosovës nuk janë domethënëse për arsye se INTERPOL-i krejtësisht ka qëllime dhe interesa të tjera nga interesat politike të Serbisë. Kështu që, përpjekjet e Serbisë bien ndesh me interesat e shteteve veç e veç të kësaj organizate, prandaj secili shtet e shikon interesin e vet. Anëtarësimi i Kosovës është interes i çdo shteti anëtar të INTERPOL-it, madje edhe i vetë Serbisë. Por, Serbia e ka për disa gjëra të tjera që ne pas anëtarësimit mund t'i kërkojmë kriminelët serbë përmes INTERPOL-it. Kjo mund ta pengojë Serbinë, mirëpo ne këtë do ta bëjmë në momentin që të anëtarësohemi. Për çdo serb të dyshuar për krime në Kosovë të çfarëdo lloji do t'i drejtohem INTERPOL-it për të na ndihmuar për t'i kapur ata", ka theksuar Selimi.

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në INTERPOL mbetet një nga prioritet kryesorë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ai ka treguar për gazetën "Epoka e re" se Kosova është vendosur në agjendën për votim në sesionin e ardhshëm të Asamblesë së INTERPOL-it që do të mbahet në fund të këtij viti. "Anëtarësimi i Kosovës në INTERPOL mbetet një nga prioritet kryesorë të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Jeni të njoftuar se së fundi kemi arritur që përmes lobimit të vendosim Kosovën në agjendën për votim në sesionin e ardhshëm të Asamblesë së INTERPOL-it që do të mbahet në fund të këtij viti. Gjithashtu, kemi një grup punues ndërinstitucional dhe ka mobilizim të gjerë, në

veçanti të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, në koordinim të procesit dhe hartimit të strategjive të lobimit për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL", ka thënë Zeka. Ndërsa njohësi i çështjeve të sigurisë dhe ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Nuredin Ibishi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se këtë vit shteti i Kosovës i ka shanset më të mira për t'u bërë pjesë e INTERPOL-it dhe, sipas tij, kjo mundësi duhet shfrytëzuar. "Edhe vitin e kaluar ishte një rast shumë i mirë që Kosova të pranohet në INTERPOL, mirëpo ky shans u lëshua dhe ende nuk e dimë arsyen pse u abstenua në momentin e fundit. Kosova ishte në pozicion shumë më të favorshëm sesa Palestina e cila u pranua, kurse Kosova u tërhoq. Pra, Palestina u anëtarësua pavarësisht prej kundërshtimit të Izraelit dhe të vendeve të tjera. Është bërë lobim i mirë nga mandati i kaluar dhe mendoj se tash

Flet për "Epokën e re", Qëndron Kastrati

Jam optimist për të ardhme

Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), njëherësh kryetar i Kamenicës, Qëndron Kastrati, është shprehur i sigurt në të ardhmen politike të këtij subjekti politik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka thënë se garanci për këtë është vullneti i anëtarëve dhe programi i PSD-së. Sipas Kastratit, për një kohë të shkurtër PSD-ja do të konsolidohet fuqishëm në çdo degë në nivel vendi. Duke folur për qeverisjen në Komunën e Kamenicës, Kastrati ka thënë se duke ndryshuar formën e funksionimit të brendshëm do të mundësojnë kursim më të madh të shpenzimeve të ashtuquajtura të luksit dhe riorientim të atyre mjeteve në fusha më të nevojshme për qytetarët. "Jam ihtar i bashkëpunimit për programe e projekte në të mirë të qytetarëve dhe nuk operoj me inate në politikë. Pres një bashkëpunim të tillë edhe nga subjektet e tjera, sidomos nga Lëvizja Vetëvendosje", ka thënë Kastrati



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), njëherësh kryetar i Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka shprehur optimizëm për të ardhmen e këtij subjekti politik. Ai ka deklaruar se PSD-ja për një kohë relativisht të shkurtër do të konsolidohet fuqishëm nëpër secilën degë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kastrati ka thënë se të ardhmen e këtij subjekti politik e bëjnë të sigurt vullneti i madh i anëtarëve të saj dhe programi konkret. "Tashmë kemi kryer zgjedhjet për strukturat qendrore. Zyra qendrore po funksionalizohet dhe detyrat organizative janë ndarë. Duke parë, në ditët e para të këtij subjekti, vullnetin e anëtarëve, jam shumë optimist që për një kohë relativisht të shkurtër do të konsolidohemi mirë dhe fuqishëm nëpër secilën degë. Programi po konkretizohet, vullneti nuk po mungon, andaj nuk ka se si të mos jem optimist për të ardhmen e Partisë Socialdemokrate të Kosovës", ka thënë Kastrati.

Ai ka treguar se dalja nga Vetëvendosja nuk i ka bërë ndonjë problem në qeverisjen komunale, ani pse bashkëqeveris me këtë subjekt politik pa koalicion formal. Sipas tij, duhet të vazhdohet bashkëpunimi për programe e projekte në të mirë të qytetarëve duke lënë anash inatet politike. "Një pjesë e drejtorëve të kabinetit tim vijnë nga subjekti Vetëvendosje edhe pse nuk kam nënshkruar një koalicion formal. Unë jam ihtar

i bashkëpunimit për programe e projekte në të mirë të qytetarëve dhe nuk operoj me inate në politikë. Pres bashkëpunim të tillë edhe nga subjektet e tjera, sidomos nga LV-ja", ka thënë ai. Në këtë intervistë i pari i Kamenicës ka treguar edhe për projektet që po i zbaton në këtë komunë, duke shtuar se gjashtë muajt e parë iu kanë nevojitur për ta skanuar gjendjen në komunë.

Kastrati është shprehur i kënaqur edhe me bashkëpunimin me Qeverinë qendrore. "Një arritje e këtyre gjashtë muajve është edhe shtimi i raporteve me nivelin qendror duke bërë shumë takime e dorëzuar shumë projekte për financim. Deri më tani përmes marrëveshjeve me ministri të ndryshme kemi arritur të sigurojmë mbi 200 000 euro donacione të cilat kanë shërbyer si infuzion për komunën tonë. Jemi në rrugë të mbarë të arrijmë edhe disa marrëveshje të tilla. Për këtë më duhet t'i falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët nga Qeveria", është shprehur Kastrati.

"Epoka e re": Z. kryetar, Gjykata Kushtetuese ka hedhur poshtë kërkesën e ish-kandidatit të LDK-së për kryetar të Kamenicës, Shaip Surdullit, që kjo komunë të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Cili është koment i juaj për këtë vendim të Kushtetueses?

Kastrati: Për ne ka qenë e pritshme një përgjigje e tillë. Nuk ka pasur mundësi tjetër përpos që ankesa e LDK-së të hidhet poshtë si e pabazuar, ashtu siç ka thënë edhe Gjykata Kushtetuese. Më vjen keq që kundërshtarët

politikë kanë bërë shumë propagandë dhe kanë humbur kohë duke shpresuar në një vendim tjetër. Tash është koha që të gjithë bashkërisht të mundohemi për përmirësimin e jetës së qytetarëve të komunës sonë.

"Epoka e re": Janë bërë disa muajt që keni ardhur në krye të komunës. Sa keni realizuar nga

projektet që keni premtuar?

Kastrati: Duhet pasur parasysh se vitin e parë ne do të qeverisim me një buxhet tashmë të miratuar nga Kuvendi Komunal paraparak. Aty janë të përfshira të gjitha investimet kapitale të parapara nga qeverisja e kaluar. Brenda mundësive jam përpjekur që punët e tenderimit të kryhen sa më shpejt e projektet e nisura

të përfundohen brenda afateve. Po ashtu, duke ndryshuar formën e funksionimit të brendshëm, do të mundësojmë kursim më të madh ndaj shpenzimeve të ashtuquajtura të luksit dhe riorientim i atyre mjeteve në fusha më të nevojshme për qytetarët.

"Epoka e re": Cilat janë prioritet

n e PSD-së



ndryshime në administratë në disa nyje kyçe në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe shpejtësia e shërbimeve. Po përgjatë kësaj periudhe kam lidhur kontakte me shumë organizata joqeveritare të huaja e vendore, me të cilat jemi duke u përpjekur të arrijmë marrëveshje bashkëpunimi për fusha të ndryshme, ku ata do të na ndihmojnë duke na financuar projektet ose duke na dhënë në shërbim ekspertizën profesionale.

"Epoka e re": Çfarë janë raportet tuaja me Qeverinë qendrore?

Kastrati: Një arritje e këtyre gjashtë muajve është edhe shtimi i raporteve me nivelin qendror duke bërë shumë takime e dorëzuar shumë projekte për financim. Deri më tani përmes marrëveshjeve me ministri të ndryshme kemi arritur të sigurojmë mbi 200 000 euro donacione, të cilat kanë shërbyer si infuzion për komunën tonë. Jemi në rrugë të mbarë që të arrijmë edhe disa marrëveshje të tilla. Për këtë më duhet t'i falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët nga Qeveria.

"Epoka e re": Ju jeni zgjedhur kryetar i kësaj komune si kandidat i Lëvizjes Vetëvendosje, kurse tani i përkisni subjektit politik PSD. Cili do të jetë bashkëpunimi me asamblistët e LV-së?

Kastrati: Një pjesë e drejtorëve të kabinetit tim vijnë nga subjekti Vetëvendosje, edhe pse nuk kam nënshkruar një koalicion formal. Unë jam ithtar i bashkëpunimit për programe e projekte në të mirë të qytetarëve dhe nuk operoj me inate në politikë. Pres një bashkëpunim të tillë edhe nga subjektet e tjera, sidomos nga LV-ja.

"Epoka e re": PSD-ja tani ka zgjedhur strukturat e saj qendrore dhe ka filluar të konsolidohet si subjekt politik në terren. Si e shihni të ardhmen politike të këtij subjekti?

Kastrati: Tashmë kemi kryer zgjedhjet për strukturat qendrore. Zyra qendrore po funksionalizohet dhe detyrat organizative janë ndarë. Duke parë ditët e para të këtij subjekti, vullnetin e anëtarëve, jam shumë optimist që për një kohë relativisht të shkurtër do të konsolidohemi mirë dhe fuqishëm nëpër secilën degë. Idetë që na bashkojnë janë programi po konkretizohet, vullneti nuk po mungon, andaj nuk ka se si të mos jem optimist për të ardhmen e Partisë Socialdemokrate të Kosovës.

tuaja kryesore për këtë vit?

Kastrati: Duke ditur që është viti i parë i qeverisjes dhe planifikimin buxhetor e kemi të trashëguar, gjashtë muajt e parë i kam shfrytëzuar për ta skanuar gjendjen, njohur stafin e administratës, evidentuar pikat e dobëta dhe ato të forta. Ky skanim i gjendjes më ka konfirmuar se duhet të bëjmë disa

Ligji për arsimtarët e viteve '90-ta përplas Kosovën me FMN-në

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Shaip Selimi ka punuar për 45 vjet mësimdhënës i lëndës së Fizikës në Shkollën Filllore "Emin Duraku" në Prishtinë, kurse në vitin 2008 është pensionuar. Selimi ka punuar edhe gjatë viteve 1990-1999, para luftës së fundit në Kosovë, kohë kjo të cilën ai e konsideron periudhën më të vështirë gjatë karrierës së tij.

Mësimi në Kosovë gjatë viteve të '90-ta është zhvilluar nëpër shtëpitë shkolla, sipas organizimit paralel që kishin vendosur atëkohë përfaqësuesit politikë shqiptarë, duke kundërshtuar nënshkrimin ndaj politikës së Beogradit dhe ish-liderit të atëhershëm serb, Slobodan Millosheviq. Për ta shpërndarë punën e mësimdhënësve të asaj periudhe, Kuvendi i Kosovës ka miratuar në parim Projektligjin për Statusin e Punëtorëve në Arsim të Viteve të '90-ta të sponsorizuar nga Qeveria. Selimi thotë se mundi dhe sakrificat e arsimtarëve të asaj kohe nuk mund të shpërndahet apo kompensohet me mjete financiare, por nëse zbatohet ky ligj, sipas tij, do të tregojë respekt dhe vlerësim i punës së realizuar. "Pavarësisht prej rrezikut në punë, në vitet '90-'99 asnjë minutë të humbur nuk e kam pasur. Aq me përkushtim dhe flim kemi punuar vetëm ta mbajmë arsimin shqip gjallë.

Kjo sakrificë nuk mund të shpërndahet me mjete financiare, me ligjin që është nënshkruar në parim. Por, unë vlerësoj se ky ligj është shenjë respekti për kontributin e asaj kohe", ka thënë Selimi.

Sipas projektligjit, mësimdhënësit që konsiderohen të jenë rreth 23 mijë, të cilët kanë punuar nga pesë deri në 10 vjet gjatë kësaj periudhe do të "shpërblehen" me 67 euro në muaj dhe pension kontribut-pagues prej 240 eurosh. Kjo nënkupton se ata në përgjithësi do të paguhet me nga 303 euro në muaj. Kurse mësimdhënësit që kanë punuar më pak se pesë vjet do të marrin 263 euro në muaj.

Këto pagesa buxhetit të Kosovës, nëse llogaritet koha nga viti 2018 deri më 2021, do t'i kushtojnë mbi 24 milionë euro, thotë zëvendësministri i Arsimin, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Hëset Sahiti. "Për vitin 2018 kostoja shtesë është 2.4 milionë euro, për vitin 2019 do të jetë 6.6 milionë euro, për vitin 2020 rreth 7.4 milionë euro dhe për vitin 2021 do të jetë 8.1 milionë euro", ka thënë ai. Por, zbatimi i këtij Ligji dhe implikimet buxhetore kanë ngritur debate dhe vërejtje nga institucionet financiare ndërkombëtare si dhe nga shoqëria civile në Kosovë.

Fondi Monetar Ndërkombëtar u ka bërë thirrje institucioneve

të Kosovës që mos të vazhdojë tutje me fuqizimin e Ligjit për punëtorët e arsimit gjatë viteve të '90-ta, sepse vlerësohet se do të ishte një kosto shumë e lartë për një vend të varfër siç është Kosova. Por, kryetari i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, Rrahman Jasharaj, ka thënë se ky ligj nuk rrezikon buxhetin e Kosovës. Ai u ka bërë thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës ta votojnë projektligjin edhe në leximin e dytë.

Kostoja vjetore, sipas tij, arrin në 6.5 milionë euro, por ndër vite kjo vlerë, siç thotë ai, do të zvogëlohet. "SBASHK-u i ka tabeloret e implikimeve buxhetore të cilat nuk janë të larta ashtu siç po paraqiten. Ne urojmë që deputetët e Kuvendit të Kosovës ta miratojnë këtë ligj në mënyrë që ta paguajnë borxhin moral të mësimdhënësve të viteve të '90-ta. Në të kundërtën, nëse ndodhin gjëra të papritura, organet e SBASHK-ut do ta shqyrtojnë situatën e re dhe pa dëshirën tonë fillimi i vitit të ri shkollor do të jetë në pikëpyetje", ka thënë Jasharaj.

Ndërsa sipas Institutit për Studime të Avancuara (GAP) kostoja e ligjit për 2019-2020 pritet të jetë rreth 30.4 milionë euro, apo për 16.1 milionë euro më e lartë sesa kalkulimet që i ka bërë Ministria e Financave për të njëjtën periudhë.



Nisin hetimet për ndarjen e 53 milionë eurove për 'Bechtel Enkan'

KLINË, 6 QERSHOR (ER) - "T'i këndojmë lirisë në liri. Shumë prej neve na duket e pa nevojë, por e vërteta është se heroi që na ka bashkuar sot këtu, Mujë Krasniqi, i ka kënduar lirisë edhe në robëri", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në manifestimin folklorik "I këndojmë lirisë", i 18-i me radhë, që është mbajtur në fshatin Çabiq të Komunës së Klinës, në oborrin e kullës së heroit Mujë Krasniqi, me rastin e ditëlindjes së komandantit të UÇK-së, Mujë Krasniqi.


Kryeministri Haradinaj me këtë rast ka theksuar se sot është mirë që i këndohet lirisë dhe sillen vlera të muzikës sonë mbarëkombëtare. "Është sakrificë e vogël sot dhe sa pak jemi duke dhënë nga vetja, sepse sot i këndohet lirisë, për të cilën dikur njerëzit kanë dhënë jetën për të pasur vlerat tona kom-

bëtare. Muzika, arti, kultura shprehen lirshëm", ka thënë Haradinaj, duke inkurajuar talentët e muzikës të vazhdojnë tutje.

Kryeministri ka thënë se Qeveria e vendit nuk do të ndalet për ta qitur në dritë të vërtetën për rrugën deri në liri dhe për ata që kanë bërë shumë për lirinë, të vërtetën për Mujën, Aliun dhe për të gjithë dëshmorët e tjerë që kanë rënë për atdhe.

Të pranishmit për pjesëmarrje i falënderoi Halil Krasniqi, babai i Mujë Krasniqit.

Pjesë e këtij manifestimi ishin edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, i cili tha se Mujë Krasniqi dhe Beqir Gashi, përveçse ishin luftëtarë të mëdhenj, me këngët e tyre ishin frymëzim për bashkëluftëtarë të tjerë. "Muja dhe Beqa i kënduan pareshtur lirisë. Ata sakrifikuhan jetën e tyre për lirinë e



vendit", ka thënë Limaj. Ai ka shtuar se Kosova do t'i nderojë dhe do t'u jetë mirënjohës për jetë të gjithë atyre që sakrifikuhan jetën e tyre për liri.

I pranishëm në këtë manifestim ishte edhe kryetari i Komunës së Skenderajt, ata Malishevës, ata Klinës, deputetë, bashkëluftëtarë të

Mujës dhe përfaqësues të tjerë të jetës politike e kulturore. Ky manifestim është organizuar nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Klinës.

Epoka e Gjergj Kastriotit, histori e luftërave për ruajtjen e identitetit kombëtar

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Me rastin e 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, nën përkujdesjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Fakulteti i Edukimit dhe Biblioteka Kombëtare "Pjetër Bogdani" kanë organizuar të enjten manifestimin "Ditët e Skënderbeut". Në këtë manifestim të 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut mori pjesë edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, i cili foli rreth historisë dhe studimit të ngjarjeve. Ai ka theksuar se kthimin për studim të ngjarjeve, historive të cilat me shekuj janë prapa nesh, e bëjmë jo për simbolikë, po për ta njohur të kaluarën. "Historia jonë kombëtare, në djepin e së



cilës u lindë krenaria, pavarësia e kombit, në veçanti i njeh katër data fatbardha: vitin 1444 kur Gjergj Kastrioti mblodhi në Lezhë Kuvendin e prijësve të krahinave të ndryshme të

Shqipërisë; vitin 1878, katërqind vjet pas, kur në Prizrenin historik Abdyl Frashëri tuboi krahët e mbarë Shqipërisë; vitin 1912 kur lindi shteti shqiptar, Shqipëria dhe vitin 2008, kur u

shpall shteti i pavarur i Republikës së Kosovës", ka thënë ministri Gashi.

Ai ka thënë se historia jonë edhe nga Epoka e Gjergj Kastriotit ishte dhe është histori e mbijetesës, e luftërave për ruajtjen e identitetit kombëtar, për ruajtjen e territoreve të hapësirës jetike shqiptare dhe për faktorizimin e elementit shqiptar. "Gjithsesi, edhe për faktin se, për ne shqiptarët, historia e qytetërimeve nuk ishte aq e mëshirshme, aq miqësore, ne u detyruam që rrugën e mbijetesës sonë ta hapim edhe me fuqinë e shpatës dhe të plumbit. Jo se ashtu deshëm, por ngaqë sunduesit, veçmas ata sllavë, në vend të paqes e të mirëqinjësisë, na imponuan luftëra.

Kështu rrodhi historia jonë kombëtare, sikur lumi i madh i epokave që rrjedh pa u ndalur, pra nga epoka skenderbegiane, deri te Epoka e UÇK-së së lavdishme me kryekomandantin Adem Jasharin", ka thënë Gashi. Në fund të fjalës së tij ministri Kujtim Gashi ka folur edhe për rrugët e integritetit euroatlantike. "Ne, pasardhësit e Gjergj Kastriotit, Ismail Qemalit, Nënë Terezës, Adem Jasharit, jemi përballë thirrjeve të qytetërimeve të reja. Sërisht, me emblemën skenderbegiane, po trokasim në portat e Evropës së Bashkuar, në djepin e kulturës, aty ku janë gjurmët, rrënjët tona, qytetërimi dhe historia shqiptare", ka thënë ministri Gashi.

Këtë muaj miratohet pakoja e projektligjeve për reformën e administratës

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Pakoja e projektligjeve që lidhen me Reformën e Administratës Publike, Projektligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore, Projektligji për Zyrarët Publikë dhe Projektligji për Pagat i hapë rrugë zbatimit të reformës dhe modernizimit të administratës publike në Kosovë. Kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj gjatë takimit me ministrin e Administratës Publike,

Mahir Jagxhilar. Në këtë takim, ku ishte i pranishëm edhe Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, kryeministri Haradinaj ka vlerësuar se miratimi i këtyre projektligjeve është i rëndësishëm edhe për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të vendit dhe përfarimin me agjendën evropiane.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se Projektligji për Paga ka kosto financiare, por garanton ruajtjen

e nivelit të pagave për të gjithë të punësuarit në administratë publike dhe të punësuarve të tjerë publikë në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë.

Ndërkaq ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhilar, e ka njoftuar kryeministrin Haradinaj për procesin e deritashëm për hartimin e këtyre projektligjeve, duke theksuar se në muajin qershor të këtij viti do ta përcjellë në Qeveri pakon ligjore të tri ligjeve bazike të administratës publike.



Limaj: Nisma po angazhohet për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë të enjten se Nisma anekënd Kosovës është kthyer në një subjekt shprese dhe mundësie për qytetarët. Në Kuvendin e Punës së Nismës në Mitrovicë, Limaj ka theksuar se energjitë i kanë drejtuar për zgjedhjen e problemeve të qytetarëve

EPOKA
ERE

Faton DERMAKU

MITROVICË, 7 QERSHOR - Nisma Socialdemokrate ka vazhduar edhe të enjten mbajtjen e Kuvendeve të Punës. Partia e Fatmir Limajt ka mbajtur Kuvendin e Punës në Degën e Mitrovicës dhe të Leposaviqit.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se anekënd Kosovës Nisma është kthyer në një subjekt shprese dhe mundësie për qytetarët e Kosovës.

Limaj ka thënë se përkushtimi i aktivistëve të Nismës ka bërë të mundur që kjo parti të kalojë suksesshëm shumë sfida për të arritur këtu ku është. Ai ka theksuar se kur ka dalë Nisma në skenën politike në vend kanë qenë dy filozofi politike: njëra, siç thotë Limaj,

mashtrojnë njerëzit përmes premtimeve, filozofia tjetër politike ka qenë ajo e sharjes dhe e nxitjes së përçarjes mes njerëzve. "Në mes të këtyre dy rrymave që ishin në tregun politik ka hyrë fryma jonë dhe nuk ka qenë lehtë. Ne besojmë se kjo është rruga që i duhet vendit. Ofrimi i njerëzve dhe konkurrimi me ide e projekte. Ne vazhdojmë të besojmë fuqishëm se në politikë duhet të ketë moral. Pa njerëz të mirë nuk ka politikë njerëzore. Ne nuk kemi kohë të merremi me të tjerët. Ne nuk merremi me gjëra të kota e mashtrime. Energjitë tona i kemi drejtuar në atë se si t'i zgjedhim problemet e njerëzve tanë", ka thënë Limaj në Mitrovicë.

Më tutje, Limaj ka folur edhe për rolin e Nismës Socialdemokrate në skenën politike në Kosovë. "Roli i Nismës ka qenë urë



bashkëpunimi mes forcave politike. Jemi marrë me tema të mëdha nacionale të cilat janë dukur të pazgjidhshme. Ne ndihemi krenarë që kemi dhënë kontribut për liberalizimin e vizave, proces ky i cili presim të ndodhë

në fund të vitit", ka shtuar Limaj. Ai ka thënë se katër zotimet e Nismës të dhëna në fushatën elektorale janë pjesë e programit qeveritar dhe po zbatohen nga ana e ministrive përkatëse. Hysni Ahmeti, kryetar i Degës së

Nismës në Mitrovicë, ka thënë se vizioni socialdemokrat i Nismës po shtrihet çdo ditë e më shumë në çdo cep të Mitrovicës.

Ai ka thënë se qytetarët e kësaj komune po e përqafojnë konceptin socialdemokrat të Nismës.

Hoxhaj: Ndryshimi fillon me rininë



PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Instituti për Studime Politike i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) ka organizuar të enjten një bashkëbisedim me të rinjtë e Rinisë Demokratike (RDK). Bashkëbisedimi me titull "Nxitja dhe promovimi i kulturës së dialogut me strukturat e Rinisë Demokratike (RDK)" është moderuar nga zëvendëskryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj dhe këshilltari i kryetarit të kësaj partie, Blerim Latifi. Fillimisht përfaqësuesi i Institutit për Studime Politike të

PDK-së, Arben Gecaj, ka thënë se ky institut angazhohet për inicimin, përgatitjen, realizimin dhe implementimin e ideve e rekomandimeve të dala nga procesi i dialogut të brendshëm me strukturat e zgjedhura të Rinisë Demokratike të Kosovës. Ndërsa zëvendëskryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka theksuar se ky dialog është duke u zhvilluar sipas normave, vlerave si dhe qëllimeve të PDK-së në raport me nevojat dhe kërkesat e kohës. "PDK-ja është forca më determinante e shtetformimit

dhe shtetndërtimit, e lidhur ngushtë me Kosovën, vizionin dhe perspektivën e saj, në dimensionin e brendshëm e të jashtëm, edhe tash në procesin integruar euroatlantik", ka thënë Hoxhaj, duke vënë në pah se ndryshimi fillon me rininë, e cila duhet të jetë kritike edhe në dekadën e lëvizjes së lirë, mirëqenies dhe ambientit. Hoxhaj ka kërkuar nga të rinjtë që aktivizimin si fazë e re e zhvillimit të brendshëm të Rinisë Demokratike ta bëjnë parim të veprimtimit të tyre cilësor.

Policisë dhe Forenzikës i dorëzohen pajisje për kontrollin e armëve

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), në bashkëpunim me Ambasadën e Gjermanisë në Kosovë, i kanë dorëzuar Policisë së Kosovës dhe Agjencisë së Forenzikës pajisje për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta. Ky donacion përfshin edhe trajnimin e personelit përkatës për përdorimin e duhur të pajisjeve të dhuruara.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Selami Shkodra, ka thënë se këto pajisje do të ndikojnë në besueshmërinë e Agjencisë së Forenzikës për zbulimin apo të provuarit e armëve. Ndërsa ambasadori i

Gjermanisë në Kosovë, Christian Held, ka theksuar se Qeveria gjermane, në bashkëpunim me Francën, është e angazhuar për shtimin e kontrollit të armëve të zjarrit.

Duke shprehur gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit, ambasadori gjerman ka thënë se mënyra se si institucionet kanë punuar për trajtimin e armëve të zjarrit në Kosovë është shembulli i mirë. Në anën tjetër, zëvendëspërfaqësuesja e përherëshme e UNDP-së, Alessandra Roccasalvo, ka thënë se Këshilli Evropian i ka ftuar Interpolin dhe Europolin me qëllim të luftimit të trafikimit të armëve.



Mehmeti: BQK-ja ka përfituar shumë nga mbështetja e Bankës Botërore

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, dhe ministri i Financave, Bedri Hamza, kanë takuar drejtorin ekzekutiv të Konstituencës së Bankës Botërore, ku bën pjesë edhe Kosova, Franciscus Godst. Guvernatori Mehmeti e ka njoftuar Godst me zhvillimet e fundit në sektorin e financave dhe bashkëpunimin me institucionet financiare ndërkombëtare, me theks të veçantë me Bankën Botërore, duke falënderuar këtë institucion për bashkëpunimin e deritashëm.

Guvernatori Mehmeti dhe ministri Hamza e falënderuan Godst që si drejtor ekzekutiv në

Konstituencën ku bën pjesë Kosova, ka përfaqësuar me korrektësi vendin tonë në forumet ekzekutive të Bankës Botërore.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i Konstituencës së Bankës Botërore, Franciscus Godst, ka vlerësuar lart situatën ekonomike dhe stabilitetin makrofiskal në Kosovë, ndërsa ka shprehur bindjen se trendi pozitiv i rritjes ekonomike në Kosovë, por edhe treguesit makrofiskal, do të vazhdojnë të jenë në nivele të kënaqshme, në mënyrë që Kosova të vazhdojë në rrugën e progresit ekonomik dhe shoqëror.

Godst ka ofruar gatishmërinë e Bankës Botërore për mbështetjen e Kosovës edhe në periudhën e ardhshme.



Fillon vlerësimi i 1 642 projekteve bujqësore

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), ka filluar procesin e vlerësimit të 1 642 projekteve bujqësore të fermerëve dhe agrobizneseve vendore, të cilat presin mbështetje përmes masave mbështetëse të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të vitit 2018. Me

rastin e fillimit të këtij procesi, ministri i MBPZHR-së, Nenad Rikalo, bashkë me ushtruesin e detyrës së kryeshefit ekzekutiv të AZhB-së, Ekrem Gjokaj, kanë mbajtur një konferencë për media, me ç'rast kanë treguar se Ministria e Bujqësisë, përveçse ka rritur buxhetin për Programin për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural të vitit 2018, e ka rritur edhe transparencën në procesin e vlerësimit të projekteve bujqësore, si dhe ka krijuar lehtësira në disa kriteret për aplikim për fermerët.

Ministri i Bujqësisë, Nenad Rikalo, ka thënë se për Programin për Bujqësi dhe Zhvillim 2018, si dhe për masat e tjera për investime në infrastrukturën rurale dhe për investimet në zonat e thella rurale, MBPZHR-ja ka planifikuar një buxhet prej 27 milionë eurosh. "Mund t'ju them se prej fillimit të hartimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2018 jemi duke u munduar të përfshijmë sa më shumë aktorë në përpilimin e tij, duke krijuar në këtë mënyrë edhe shumë lehtësira

për fermerët të cilët aplikojnë për të përfituar grante investive. Po në këtë proces një punë shumë të mirë e ka bërë edhe Departamenti për Politika të Zhvillimit Rural. Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha këto, besoj se implementimi i këtij programi do të japë rezultate konkrete për zhvillimin ekonomik të vendit", ka theksuar Rikalo. Gjithashtu, ministri Rikalo ka njoftuar se, krahas këtyre programeve aktuale, tashmë janë afër nënshkrimit të një marrëveshje me USAID-in për

financimin e projekteve të përbashkëta bujqësore për sektorin e pemëve të imta dhe sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike e që, sipas tij, ky do të jetë një program shumë atraktiv dhe i kapshëm për fermerët e vendit. Në anën tjetër, ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të AZhB-së, Ekrem Gjokaj, ka njoftuar se organi implementues i Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural i ka ndërmarrë të gjitha masat që gjatë tërë kohës të ketë një vlerësim të drejtë dhe transparent.

Kosova, pjesë e shënimit të 'Ditës Botërore të Konsulencës'



"Business Consultants Council" (BCC) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) kanë organizuar takim në nivel të institucioneve publike dhe private për ndikimin e këshillëdhënës dhe vlerën e operimit të saj në institucione

bizneset private dhe kompanitë e ndryshme kanë nevojë për këshillëdhënie bazuar në fushëveprimet e ndryshme dhe se MTI-ja është e përkushtuar që përmes projekteve që financohen nga Komisioni Evropian, COSME, Banka Botërore t'i ndihmojnë ndërmarrjet lokale dhe në këtë drejtim këtu konsulentët luajnë rol të madh në zhvillimin e projekteve investive për këto ndërmarrje.

Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë, Arsim Koliqi, ka thënë se kjo agjenci është duke ndërmarrë projekte si për sektorin publik, po ashtu edhe për atë privat që kërkojnë angazhim të konsulentëve për implementim të tyre. "Ministria e Zhvillimit Ekonomik do të implementojë investime me vlerë prej 31 milionë eurosh për eficiencën e energjisë dhe do t'i angazhojë konsulentët", ka thënë ai.

Kurse Visar Dobrosi, sekretari

i Bordit të BCC-së, ka thënë se BCC është ombrella e vetme e konsulentëve vendorë nga fushëveprime të ndryshme të cilët ofrojnë shërbime kualitative dhe e përkushtuar ta rrisë përgjegjësinë tek konsulentët dhe kompanitë konsulente për të qenë transparent dhe të përgjegjshëm.

Ndërsa Leonora Kusari, menaxhere në Departamentin Këshilla për Biznese të BERZH-it, ka prezantuar perspektivën dhe sfidat e tregut të konsulencës në Kosovë, si dhe përkrahjen e vazhdueshme të këtij institucioni për ngritjen e kapaciteteve të konsulencës vendore të cilët kanë ndihmuar bizneset kosovare në zhvillimin e mëtutjeshëm të tyre. "BERZH-i ndër vite ka trajnuar mbi 360 konsulentë vendorë dhe ka angazhuar mbi 230 sosh për të implementuar projekte të këshillëdhënies tek mbi 800 NMVM, e cila përkrahje financiare kap vlerën mbi 7.5

milione euro falë kontributit të donatorëve si Bashkimi Evropian, Holanda, Fondi i Veçantë i Aksionerëve të BERZH-it, Luksemburgu dhe Suedia. Vetëm në tre vjetët e fundit 63 % e ndërmarrjeve të përkrahura kanë rritur punësimin, 78 % e tyre kanë rritur produktivitetin dhe 9 % e tyre kanë arritur të tërheqin investime mbi 19 milionë euro", u shpreh ajo.

Në fund, drejtoresha e BCC-së, Jehona Lluka, ka ftuar konsulentët të anëtarësohen dhe regjistrohen në platformë si dhe kompanitë dhe shoqatat të anëtarësohen dhe të përfitojnë nga shërbimet e këshillëdhënies. Po ashtu, Lluka ka ftuar edhe ministrinë të bashkëpunojnë dhe koordinojnë aktivitetet që ndërlihen me angazhimin e konsulentëve për implementimin e projekteve publike dhe përkrahjen në zhvillimin e projekteve për sektorin privat.

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Në Kosovë është shënuar "Dita Botërore e Konsulencës" e cila shënohet në 50 shtete të ndryshme të botës dhe me këtë rast "Business Consultants Council" (BCC) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) kanë organizuar një event në nivel të institucioneve publike dhe private për ndikimin e këshillëdhënies dhe vlerën e operimit të saj në institucione.

Ngjarja u shënuar edhe me nënshkrimin e nëntë memo-

randumeve të bashkëpunimit mes BCC-së dhe Innovation Centre Kosovo (ICK), Odën Ekonomike Britanike, IPKO Foundation, G7, CEED Kosovo, Shoqatën KAMA, Shoqatën STIKK, Shoqatën e Përpunimit të Metalit dhe Energjisë së Ripërtërishme dhe Shoqatën e Përpunimit të Drurit, të cilat do të kontribuojnë për shkëmbimin e shërbimeve, bashkëpunimeve dhe zhvillimin mes institucioneve nënshkruese.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka përgëzuar manifestimin e ditës botërore të konsulencës në Kosovë. Ai ka thënë se

Në objektin e Komunës së Kamenicës hapet një zyrë postare

KAMENICË, 7 QERSHOR - Posta e Kosovës (PK) ka hapur një zyrë postare në hapësirat e Komunës së Kamenicës, në të cilën qytetarët kanë mundësi të kryejnë pagesa të ndryshme me provizionin më të ulët në vend.

Marrëveshja e nënshkruar të enjten ndërmjet kryeshefit ekzekutiv të Postës së Kosovës, Sejdi Hoxha, dhe kryetarit të Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, u jetësua edhe me përrurimin e Zyrës Postare. Me këtë rast, Hoxha ka uruar qytetarët e Kamenicës që nga sot iu krijuan kushtet që të gjitha shërbimet t'i kenë brenda një objekti, ndërsa u bëri thirrje edhe kryetarëve të komunave të tjera të Kosovës që ta ndjekin shembullin e Kamenicës, Gjilanit, Prishtinës, Mitrovicës, Prizrenit dhe Rahovecit, për t'i mundësuar



Postës së Kosovës t'i ofrojë shërbimet postare sa më afër qytetarëve.

Posta e Kosovës, e licencuar nga BQK-ja për shërbimin

financiar jobankar, ofron kryerjen e pagesave për qytetarët e Kosovës, pa provizion ose me provizion shumë të ulët, në mbi 140 zyra postare.

Nënshkruhet marrëveshja për uljen e izolimit socio-ekonomik

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, dhe drejtoresha për Kosovë e Këshillit Danez për Refugjatë (DRC), Kristen Stec, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, e cila ka për qëllim uljen e izolimit socio-ekonomik të komuniteteve pakicë dhe komuniteteve të cenushme në Mitrovicë, si dhe përgatitjen e tyre për tregun e

punës, me fokus gratë, të rinjtë dhe të rikthyerit. "Falënderova znj. Stec për bashkëpunimin dhe i ofrova gatishmërinë e plotë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për projekte të ngjashme edhe në të ardhmen, ku kërkova që të tilla iniciativa të shtrihen edhe në komuna të tjera të Kosovës", ka thënë ministri Reçica pas nënshkrimit të marrëveshjes.



AFK-ja ndihmon me një donacion çerdhen 'Zërat e ëmbël'

MALISHEVË, 7 QERSHOR (ER) - Çerdhja publike e fëmijëve "Zërat e ëmbël" në Malishevë të enjten ka marrë një donacion me lodra nga Agjencia për Financim në Kosovë (AFK), njësisia në Malishevë, në vlerë prej 500 eurosh. Me rastin e dhënies së donacionit ishin i pranishëm edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, dhe drejtori i Arsimit, Blerim Thaçi. Me këtë rast, nënkryetari Berisha e ka falën-

deruar AFK-në për këtë donacion me lodra për fëmijët. "Ne e kemi hapur këtë çerdhe dhe synojmë të zgjerohemi edhe me një çerdhe tjetër, por çdo lloj donacioni që vjen është i mirëseardhur, sepse na ndihmon edhe neve për plotësimin e nevojave që kanë fëmijët", ka thënë Berisha. Edhe drejtuesit e çerdhes publike "Zërat e ëmbël" në Malishevë kanë falënderuar AFK-në për këtë donacion të lodrave për fëmijët.



Kolegji AAB dhe Komuna e Junikut nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi

JUNIK, 7 QERSHOR (ER) - Me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në pajtim me interesat e përbashkëta, Kolegji AAB dhe Komuna e Junikut nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi. Të dy institucionet nëpërmjet kësaj marrëveshje të nënshkruar nga rektori i Kolegjit AAB, Lulzim Tafa dhe kryetari i Junikut, Agron Kuçi, pajtohen që në të ardhmen të bashkëpunojnë në nisma të ndryshme për promovimin e arsimit cilësor nëpërmjet aktiviteteve të për-

bashkëta. Rektori Tafa ka falënderuar kryetarin Kuçi për gatishmërinë e shprehur për bashkëpunim me Kolegjin AAB, duke thënë se ky institucion do të angazhohet me të gjitha kapacitetet që ka, që kjo marrëveshje bashkëpunimi të gjejë implementim sa më të suksesshëm. Ndërsa Kuçi ka theksuar se tashmë përmes këtij bashkëpunimi konkret do të zgjerohet bashkëpunimi ekzistues arsimor, shkencor dhe kulturor. Kjo marrëveshje bashkëpunimi

përfshinë edhe kryerjen e punës praktike për studentët e Kolegjit AAB në institucionet/departamentet, drejtoritë, agjencitë, institucionet shkollore dhe parashkollore të Komunës së Junikut si dhe e vizita të ndërsjella të të dy institucioneve. Kolegji AAB me këtë marrëveshje do të ofrojë edhe bursa të plota për nxënësit më të mirë të Komunës së Junikut, në cilindo nga programet e studimit, si dhe pika të tjera që janë në interesin e përbashkët ndërinstitucional.



Projekti i shkallëve në lagjen 'Arbëria' po realizohet sipas planit

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se projekti i shkallëve në lagjen "Arbëria" po realizohet sipas planit të para-

parë. Ahmeti ka thënë se rreth shkallëve janë shtuar tashmë dhe do të shtohen edhe më tutje sipërfaqet e gjelbra. "Punimet po bëhen në rreth 300 metra gjatësi dhe shkallët do të jenë të

gjera 2.5 metra. Brenda këtij projekti po punohet edhe për rregullimin e kanalizimit atmosferik, ndriçimit dhe hapësirave përcjellëse për pushim", ka thënë Ahmeti.

Brenda këtij viti Fushë-Kosova do të ketë furnizim me ujë 24 orë

PRISHTINË, 7 QERSHOR (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka paralajmëruar se me investimet që do të bëhen së shpejti në rrjetin e ujësjellësit, Komuna e Fushë-Kosovës brenda vitit do të ketë furnizim me ujë 24 orë. Këto komente ministri Lluka i ka bërë të enjten gjatë vizitës në Komunën e Fushë-Kosovës. Ministri Lluka në këtë vizitë ka qenë i shoqëruar edhe nga



drejtori i KRU "Prishtina", Ilir Abdullahu, me ç'rast, me kryetarin e komunës, Burim Berisha, kanë diskutuar për furnizimin e rregullt me ujë për këtë komunë dhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik.

Rruga për në varrezat e reja në Vinarc asfaltohet para Bajramit të Madh

MITROVICË, 7 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka inspektuar punimet për ndërtimin e rrugës për në varrezat e reja të përbashkëta të fshatrave Vinarc e Gushafc, në një gjatësi prej afër 1 800 000 metrash, që buxhetit të komunës do t'i kushtojë rreth 170 000 euro. Bahtiri me këtë rast ka kërkuar nga kompania punëkryese



"Bajraktari" sh.p.k që t'i kryejë punët në mënyrë cilësore dhe që t'i respektojë afatet e kontratës, përkatësisht që ajo të kryhet para Bajramit të Madh.

A MUND TË MERRET KJO FUSHATË TURISTIKE SI LOBIM, APO NDËRKOMBËTARISHT DO TË NOTERIZOHET SI DËSHTIM DHE DISKREDITIM?



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Pa gjeografi nuk ka pavarësi: Institucionet e Kosovës, përkatësisht Kuvendi i këtij vendi të pavarur dhe sovran, kanë vendosur përfundimisht ta bindin botën e painformuar, se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për liberalizim të vizave, madje me plotësimin e këtyre kushteve si bonus kanë fituar të drejtën të lëvizin lirish edhe në Kolumbi, Meksiko, Peru, Guatemalë, Gabon, Mauritan, Somali, Çad, Mali, Kongo dhe shtete të tjera ku demokracia ka traditë shekullore. Deri më tani ka pasur lobime të niveleve të larta sikur nga presidenti dhe ministri për Punë të Jashtme dhe personalitete të tjera Kosovës që bota iu për (k)ulet me respektin më të madh, por se nuk janë treguar aq të suksesshme. Edhe Shqipëria ka kontribuar shumë në këtë drejtim, sidomos politikanët që tymosin duhan të Lazaratit. Jemi dëshmitarë se Izraeli fort po e përkrahë Kosovën, e ka njohur moti pavarësinë e saj andaj, me të drejtë shkojmë atje, përqurimi dhe vajtojmë te Muri i Lotëve. Për Vatikanin nuk kemi ç'të flasim, se ka shkuar përtej Rezolutës 1244, duke deklaruar se Kosova është jo vetëm pjesë, por djep i Serbisë. Prandaj i biem në gjunjë çdo Pape dhe çdo kardinali. Sipas disa politikanëve, njohja nga Vatikan është çështje orësh dhe kështu flitet në 10 vjetet e fundit. Izraeli na ka ndihmuar shumë me konsulenca të tipit Thaçi and Saçi për çka i kanë rruar disa milionë euro sikur edhe me kriminelët që kanë dërguar pacientë të varfër për t'ua marrë organet dhe për të treguar me to. Po në të njëjtin rrafsh janë edhe disa shtete islamike që aq shumë e ndihmojnë Kosovën, me së paku 90 % të besimit islam, duke investuar në Serbi miliarda dhe miliarda dollarë dhe euro. Dhe duke u përbetuar, sipas bekimit papënorë se kurrë nuk do ta njohin pavarësinë e

Kosovës. Në disa raste, disa shtete islamike janë më ekstreme se vetë Serbia në mohimin e pavarësisë së Kosovës. Për fat të mirë sot ka ndryshuar situata, kemi politikanë të jashtëzakonshëm dhe deputetë që nuk i ka asnjë shtet evropian dhe se nuk ka gjasa t'i ketë. Pikërisht për këtë, për t'i bindur edhe skeptikët apo mohikanët e fundit të mohimit të liberalizimit të vizave, një armatë e tërë apo një delegacion heterogjen, por jashtëzakonisht i përkushtuar, sakrifikues, i pastër si loti, që nga nesër do ta fillojë lobimin për sigurimin e liberalizimit të vizave për ta dhe anëtarët e familjes së tyre sikur edhe shpurës që i shoqëron, deri në mëditjen e fundit! Aty ka ish-luftëtarë të ish së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës, ekonomistë të denjë për Çmimin Nobel për Letërsi, këshilltarë të Pelave të Shamallukut, mbrojtës të përkushtuar të pronës publike të cilët, për shkak të humbjes së besimit të institucionet e vendit, paratë dhe të mirat e tjera materiale i ruajnë në objektet ku jetojnë apo ordinojnë, profesionistëve për shërbime orale (folës të spikatur), gazetarë të shquar për profesionalizëm të porositur dhe bosht kurrizor të tipit Harribo, deputetë që kanë fituar vota pa pasur fare nevojë për familjarët e tyre të famshëm, mbrojtës dhe njohës të çështjeve politike, ekonomike, sociale dhe filozofike që do t'ua kishte lakmi edhe vetë Ciceroni i famshëm. Kanuni i Lekë Dukagjinit, përkundër Kanunit të Lekë Lumezit, na mëson për hakmarrje dhëmb për dhëmb dhe sy për sy prandaj kurrë nuk do t'ia falim Vjenës që nuk na lejojë ta pushtojmë Eu(v)ropën, duke na ndalur te muret e Vjenës dhe duke i mposhtur sulltanët e Perandorisë Otomane prandaj edhe këtë fushatë po e fillojmë me Austrinë, përkatësisht Vjenën. Çka na duhet Moxarti kur i kemi shahirët dhe profesionistët e dajreve dhe dauleve?! Me këtë ofensivë "diplomatike" po i shprehim mirënjohje dhe përkushtim Davutogllut dhe Erdoganit, për ta rikthyer lavdinë në të gjitha pjesët e botës që kanë qenë në sundim otoman apo që kanë dashur të futen nën këtë sundim. Pastaj, Vjena është

kryeqytet i diplomacisë botërore dhe duhet të ndihet e nderuar që diplomatët kosovarë, përkundër agjencës së ngjeshur, po e ndajnë një kohë për të ligjruar në këtë akademi diplomatike e që, dorën në zemër, është në nivel shumë më të ulët se akademia diplomatike e Bashkurcit në të cilën kanë diplomuar shumica e deputetëve të Kosovës dhe plejada e shkëlqyer e diplomatëve kosovarë. Aty mund të takojnë edhe pensionistët si Rohan dhe Petriq, miq të presidentit tonë të respektuar dhe t'u tregojnë se pjesë e delegacionit është një diplomate e shkëlqyer, ligjruese në shumë akademi diplomatike botërore, shkruese dhe përpiluese e të gjitha dokumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare, që nga Konferenca e Dejtonit e deri më tani, ndryshe mbesë e presidentit si dhe trashëgimtarja e kapitalit politik të ish-presidentit duke ua sqaruar se këto dy shpresa diplomatike janë lutur shumë nga populli i Kosovës që të bëhen deputete dhe se është dashur të derdhen shumë lot, djersë e sidomos para, ta pranojnë këtë përgjegjësi. Kur ta pushtojnë Vjenën, do ta thërrasin Erdoganin dhe Davutogllun për t'u treguar se e përmbushëm amanetin sikur që do të bëjmë edhe flijime të tjera për shpirtat e sulltanëve që nuk e kanë pushtuar Vjenën. Meqë nuk kemi koqe ta kalojmë Urën e Ibrit sepse ia kemi frikën Rakiqit prej të cilit Agimi përsurret me ta dëgjuar emrin e tij, qoftë prej frikës, qoftë nga kënaqësia, pa asnjë frikë do të marshojmë nën Portën e Bradenburgut. Për disa nga delegacioni, Parisi do të jetë vendi ku për herë të fundit do ta kenë rastin ta luajnë Tangon e fundit në Paris, për ta vazhduar edukimin muzikor në Dubravë apo Gërdoc. Ndërkaq, për disa të tjerë që duan ta parashohin fatin ashtu siç dëshirojnë, Roma është destinimi më i pëlqyer për ta. Saktësisht, për dikë që ka "strehuar" miliona euro para të shtetit në xhepat e tyre, Roma është qytet i bekuar për ta sepse, duke hedhur disa monedha, euro apo centë metalike në Fontana Trevi, mund të kërkojnë përmbushjen e dëshirave të tyre e në rastin konkret është që prokurorët dhe gjykatësit e EULEX-i, të kenë jetë të gjatë dhe shëndet të mirë dhe ta

vazhdojnë misionin e tyre "të sundimit të ligjit" në Kosovë, në mënyrë edhe më konsekuente, duke u bërë ombudsperson i krimit të organizuar dhe korrupsionit për çka kanë dhënë dëshmi që nuk mund të mohohen. Pyeteni për këtë ish-prokuroren Bamieh dhe gjyqtarin Simons, që të dy, në mesin e shumë të korruptuarve të tjerë, edhe vetë janë pjellë e EULEX-it. Numri i madh i këtij delegacioni, po të ishte formacion ushtarak gjatë luftës së fundit në Kosovë, do të ishte përcaktues edhe për Betejën e Koshares dhe, po ky formacion lobues, i përkthyer në formacion ushtarak, po t'i shkonte në ndihmë komandantit legjendar në Prekaz, historia e Prekazit do të dukej dhe shkruhej ndryshe! Ky delegacion dhe në këtë përbërje, me njohuritë politike dhe diplomatike që nuk i ka, jo që nuk ka kapacitet t'i bindë burokratët e rryer dhe të regjur evropianë për të arriturat por se, pasi t'i kenë dëgjuar, ekziston rreziku potencial t'i fusin kufizimet për lëvizje edhe brenda territorit të Kosovës e lëre më ta fitojmë Shengenin. Nga përvoja e gjatë me "miqtë" ndërkombëtarë jam bindur se kur të thonë se keni bërë punë të shkëlqyer nënkupton se na konsiderojnë budallenj ordinerë ndërsa, kur e shtojnë se keni t'i bëni edhe disa punë shtesë nënkupton se mund të bëhemi budallenj edhe më të mëdhenj! Pastaj, duhet ta kemi të qartë se ka kaluar koha e Ali Bungut kur, për shkak të mungesës së teknologjisë informative, kemi folur ç'kemi dashur dhe se edhe budallakinë më të madhe e kemi llogaritur si diçka gjeniale. Tash, shtetet ku po "lobojnë" urtakët dhe të mençurit e Kosovës i kanë vëzhguesit dhe diplomatët e tyre në Kosovë dhe i njohin të gjithë anëtarët e armatës lobuese, edhe më mirë se që e njohin ata veten e tyre. E njohin Kuvendin, kush çka diskuton dhe si diskuton, kush dhe si u bë deputetë, kush është në dashuri me gjyqin dhe a ka përfunduar divorci me gjykatën për shkak të hajnive dhe shpërdorimeve milionëshe etj. Ne jemi mësuar t'i shesim njëritjetrit dushk për gogla, në perëndim nuk e njohin këtë lloj të tregtisë. Është një rregull i pashkruar me të cilën mbrohet apo bëhet publike injoranca i

një personi! Dukja e një personi mund dhe është vetëm udhëzues apo sinjalizues identifikues për një injorant potencial, hapja e gojës përveç se e tregon higjienën orale dhe gjendjen e dhëmbëve, nëse shoqërohet edhe me fjalë, bëhet tregues e 100 % e injorancës së dikujt. Prandaj, është edhe rregull elementar i mirësjelljes që të mbani gojën mbyllur kur konsumoni ushqim kur jeni budalla, është pasuri më e vlefshme se të gjitha paratë që i keni vjedhur! Bekimi po vazhdon ta përdorë të njëjtën meny ushqimore duke deklaruar se nuk tregohen kompromiset, pa u arritur marrëveshja sikur që është duke folur për ngjyrën dhe madhësinë e të brendshmeve të ndonjë kurtizaneje që paguhet për shërbimet e jo për fatin e një vendi dhe 2 milionë qytetarëve të saj. Madje, kësaj menyje kontaminuese po ia shton edhe një mëlmesë apo delikatesë se Shefi i Tij qenka paracaktuar për rolin e pazëvendësueshëm të kryenegociatorit, pavarësisht kundërshtimeve, duke e barazuar me Pejagmerin Muhamet apo Abrahamin (Ibrahimin), Moisin apo Musën. Çka është e tepërt, është e tepërt, qoftë edhe nga Bekimi prandaj e sugjeroj ta lexojë paragrafin paraprak, nëse nuk dëshiron të shkojë në "shportën e mbeturinave". Kurse, kryetarit të Kuvendit i isha drejtuar me një lutje; lëri këta deputetë të bëjnë Bajram me anëtarët e familjes dhe të afërmit. Ramazani është muaj i rahmetit dhe solidaritetit. Mos i ngushto duke ua vënë një barrë të cilën nuk mund ta bartin, as fizikisht e lëre më politikisht. Liroje edhe veten tënde! Jam në pritje që i Madhërishti president të ma ndajë një znaçkë sikur disa patriotëve të mëdhenj dhe intelektualëve që ua ndau këtë javë. Unë jam rast sui generis prandaj i meritoj dy dekorata për jubilen e 10-vjetorit të pavarësisë, një znaçkë rreth qafe nga presidenti dhe një pirsing në vesh nga Shpend Ahmeti në mënyrë që të fitojë të drejtën të shtrihem gjerë e gjatë shesheve të Prishtinës, të lehtë kur të dua dhe sa të dua, të sulmoj dhe kafshoj kur dhe kënd të dua (e di kënd duhet ta kafshoj). Shëndet dhe jetë të gjatë për të dy kryetarët, Hashim Thaçin dhe Shpend Ahmetin!

Filialet e shërbimeve sekrete jugosllave në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame (3)

- Hoxhallarët komunistë marksistë-leninistë jugosllavë dhe nacionalistët shqiptarë



Bardhyl MAHMUTI

'Teglla' do të dëshmoheste si më i zellshëm dhe më bashkëpunëtorë, nuk do të ndjehet i ofenduar që të më raportojë mua çdo ditë e unë një herë në javë te Kiro Fuzofski, kurse 'Mandolina' do të jetë më kryeneç, më i poshtër, ai kurrë nuk do të pranojë të bashkëpunojë me mua, por, drejt e me shkijet e Draçevës e të Autokomandës. Pisi kishte nisur të më konsideronte si rival të tij, më shihet si konkurrent, e jo si epror të vetin. Prandaj edhe kurrë nuk arrita t'ia jap ndonjë detyrë por as të marr ndonjë informacion prej tij. Kjo më pat shtyrë që të betohem në vete që tan jetës të merrem me të, ta poshtëroj ku të mundem e t'ia nxi fytyrën në çdo mexhli ku do ta takoj". Sulejman Rexhepi sjell detaje se si kishin spinuar veprimtarinë e një atdhetari: "Në Kondovëjetote njëfarë Haxhi Enveri, i ardhur nga rrethi i Gjilanit, i burgosu politik dhe, irredentist i papërmirësueshëm. Pa dyshim, nga rrahja e tepërt që e kishte hëngë nëpër stacione policore, kishte luajtur pak mendsh, nuk ishte sagllam". (Memoari nr. 36)

Në memoaret e veta Sulejman Rexhepi evokon kujtime nga periudha e mbledhjeve të Lidhjes së Komunistëve të Maqedonisë, gjatë së cilave ky "hoxhë komunist" fitoi pushtet në raport me komunistët e tjerë, sepse kishte mbështetjen e Shërbimi Sekret të Zbulimit dhe Kundërzbulimit të Jugosllavisë. "Askush nuk më reagonte, sepse të gjithë ishin të bindur se, kur flet Mulla Sula, në fakt kanë folur organet më të larta të Lidhjes Komuniste. Pastaj, ato paraqitje kritike të mijat diskutoshin në Këshillin e Shkupit, me hoxhallarë e me xhematë. Tani më po bëhesha me krah, po fuqizohesha gjithnjë e më shumë. Sherif Dehari, edhe pse me pozicione më i madh se unë, si në Parti ashtu edhe në Bashkësi, megjithatë gjunjëzohet para meje. Për mua nëpër mbledhjet e forumeve të Bashkësisë Islame fliste si për një fuqi më të madhe që e ka pasur ndonjëherë Bashkësia Islame. Në organet partiake flitej për mua si për një komunist të paprekur kurse në BI

flitej për një hoxhë të papërkulur! Kjo ishte propaganda më e madhe për mua e cila m'i hapte të gjitha shtigjet drejt karrierës sime. Duhej të arrija majën e autoritetit të fuqishëm. Pa dyshim, kjo arritet vetëm duke qenë i përkushtuar pas vlerave të sistemit politik shoqëror si dhe duke e disiplinuar xhematin i cili duhet të arrijë shkallën e besueshmërisë së paluhatshme ndaj udhëheqësit të vet fetar. Atë çka e thotë Mulla Sula, asaj thuaj AMIN! Kështu ka qenë në Komunizëm, kështu duhet të vazhdojë edhe në demokraci. Si sistemi, si xhemati - Mulla Sulës duhet t'i thonë AMIN" (Memoari nr. 17).

Nuk do t'i përmend të gjithë emrat, të cilët Sulejman Rexhepi i cilëson si njerëz të UDB-së. A ka ndonjë emër që e ka futur për shkak të rivaliteteve brenda Bashkësisë Fetare Islame, këtë e di ai vetë. "Rezultatet për të notuar në mes valëve të komunizmit jugosllav dhe besimtarëve islam ia atribuon eprorit të vet të sigurimit sekret: "ndoshta 'faji' për këtë ishte krejt te Kiro Fuzofski, mësuesi im më i dashur përgjatë tërë karrierës sime. Asnjëherë nuk shkoja në vizitë të ndonjë xhemati paraprakisht pa u përgatitur nga Kiroja. Më mësonte mirë se çka të flas, si të flas dhe ku të godas. E unë flisja vetëm për Titon dhe për sistemin komunist, flisja rrjedhshëm e guximshëm, qetë dhe me maturi, herë-herë duke e dridhur buzën përvaishëm e duke u përplotur dhe, më së shumti godisja në vëllazërim-bashkimin tonë (...) Kiroja, krejt duke qeshur me zë, duke më rrahur shpinës e duke më përqaftuar si vëllai vëllain, më thotë, o Sulo, o nuk ka më trim se ti bre. Hallall të qoftë. O krey zjarr je, je prush që të përvëlton, që t'i djeg të gjitha tezat e që t'i përmbysë të gjitha teoritë. Je zjarr! Hajde të hapim një nofkë të re për ty. Tash e tutje për mua dhe për të tjerët, atje poshtë në zyret tona, ti do të njihesh si "Zharko"! Natyrisht, e shtruum muhabetin, pasi tashmë e kishim vlarë e pjekur edhe lepurin e egër. E çuam "çuturicën" (fjalë serbe për 'bucelë', 'shishe' alkoholisqarim BM) e mbushur me verë të kuqe e për nderë të nofkës sime të re. "Zjarr", "Prush", "Zhar- Zharko", Shejtan bre, kurrë falë mos i qofsha askujt dhe prej askujt mos u varsha! Kush më do mua, duhet të më nënshtrohet, nëse jo në p.s."

(Memoari nr. 40).

Në memoarin nr. 42, të titulluar "Unë, Mulla Sula, kryetar i BFI-së", deklaron në mënyrë triumfale: "Më në fund u kurorëzua aktiviteti im shumëvjeçar në ruajtjen e vlerave të komunizmit, në ruajtjen e ish-Jugosllavisë si dhe në luftë kundër seperatizmit dhe irredentizmit shqiptar. Tani erdhi momenti për ta përjetuar ndihmën e të gjithë atyre që i ndihmova për më shumë se njëzet vjet. U bëra kryetar i BFI-së! Paraprakisht, me të gjithë drejtuesit e këshillave të BI-së, si dhe me kryetarin e atëherëshëm të Kuvendit të BI-së kishin punuar strukturat e caktuara të shtetit. U kishin dhënë direktivë që të më votojnë mua. Tërë këtë aktivitet e kishin bërë larg syve të mia, unë nuk dija asgjë, thjesht, për të ma lehtësuar punën e mëtejme, duke qenë i bindur unë se të gjithë ata më donin mua dhe vetëm mua. Pasi u përzgjedha, e kuptova tërë lojën që e kishin luajtur. Kjo më irritoi shumë, sepse nuk e dija se cila palë po e tregon të vërtetën: ata të shërbimeve të sigurisë, apo teologët. Nuk e di as vetë kur ndodhi në mua ai moment i kthesës por, di që për një moment kam thënë: tash e tutje duhet lidhur me hoxhallarët e kundër atyre shërbimeve që asnjëherë nuk janë të nderëshëm në detyrën e tyre. Largimi im prej tyre u bë me kryeneçësi, u bë me rebelizëm, u bë duke u futur vetë në ato kanale nëpër të cilat futeshin dhe jetonin vet ata të shërbimeve. Kalova në nacionalist i madh shqiptar, sepse, e dija që kjo do t'i lëndojë më së shumti ata dhe se, tani, për herë të parë, do të ndodheshin para një situatë të palakmueshme: një nacionalist transparent nuk do të mund ta burgosnin. Unë isha kryetar i të gjithë myslimanëve dhe, çdo burgosje eventuale e imja do ta përmbyste shtetin. Atyre u dola dorësh, ndërsa si hakmarrje ata e përdorën liferimin e nofkës sime prej kodoshi ("Zharko") si dhe hedhjen në publik të segmenteve nga aktivitetet e mia deri sa bashkëpunoja me ta. Ja, për herë të parë, publikisht, përmes këtij memoari po e pranoj që kam bashkëpunuar me ta dhe po ju kërkoj falje të gjithë atyre që i kam lënduar e dëmtuar. Bashkëpunimi im ka pasur një qëllim shumë fisnik - thjesht, të bëhem kryetar i kësaj Bshkësie, sepse e kam ditur se, nga ky pozicion do të mund t'i ndihmoja shumë shqiptarëve". (Memoarin nr. 42).

Megjithatë Sulejman Rexhepi

nuk e ka të lehtë të shpëtojë nga kthetrat e Shërbimit të Zbulimit dhe Kundërzbulimit. "Ma bënë krejt vrer postin e kryetarit, nuk arrita t'i gëzohem asnjë çast. Derisa nuk u çarta fare. Pas një kohë e thirra Kire Fuzofskin duke e qortuar se si më lanë si qengjin në kafazin e mbushur përplot me ujçër. U takuam te restoranti i Hotel Belvit. Vendosa që t'ia tregoj planin që kisha me këtë rebelim timin, ndërsa si kundërshtpërbllim kërkova që të më mësojë se si të sillem me 'çakejt' që po më silleshin panda! UDB po insistonte përmes metodave të ndryshme që në BI të hapte filialen e vet dhe të instalonte njerëz që do ta kontrollonin dhe do të raportonin për punën time. Nuk e kuptoja se pse duhej të më kontrollonin mua! 'Jo', më tha Kiroja! 'Nuk është për shkakun tënd, por për prestigjin e drejtorisë sonë. Nuk guxon të ngelë institucion pa pasur njerëz tanë aty, sepse do të ngel jashtë kontrollit të drejtorisë. Çdo gjë që ngel jashtë nesh rrezikon të shndërrohet kundër nesh!' Ky shpjegim sikur më zbuti. Më frikësoi kur më tha se, nëse nuk do të pranoja do të bënin ç'mos që sërish ta rikthenin në BI Jakup Selimovskin me ekipin e tij. Ky plan më acaroi shumë. Atëherë, e luta Kiron që ai ta kishte nën kontroll krejt BI-në. Nuk do të shpëtonte gjë pa ditur ai dhe se, nuk do të veprohej asgjë pa këshillat e tij, me kusht që tjetër bashkëpunëtorë të mos më fusnin në hundë. Këtë nuk mundi të ma garantojë Kiroja, por, m'i dha emrat se kë po mundohen t'm'i fusin në kabinet, ndryshe do t'i kisha armiq të përherëshëm dhe përherë do të më bënin probleme". Listën e parë të emrave të propozuar nuk i pranoi dhe madje sipas fjalëve të tij u kërcënua se do të shndërrohej në armik të madh. "Disa ditë më vonë, Kiro Fuzofski më erdhi me një ofertë të re. Më luti që të zbutem, ta ul pak kokën se, 'bozhe mili' (shprehje në gjuhën serbe që do të thotë 'zot i dashur-sqarim BM)jemi njerëz dhe, sakaq mund të hidhemi diku në hendek duke plasur ndonjë gomë veture, apo, si gjyqtar, të na kap ndonjë 'plumb bredhës'. Më frikësoi dhe, pa e zgatur shumë pranova t'm'i lexojë emrat të cilët duhet të futen me porosi në kabinet. Sa të jesh në krye të BFI-së, ti nuk mundesh të funksionosh pa i pasur pranë vetes sidomos këta emra: Zejnulla Fazliu, Shaqir Fetahu, Pëllumb Veliu, Isa Ismaili, Muhamed Iseni, Zenun Berisha dhe Sherif

Dehari! Aaaa, mendova zëshëm! Në këta emra paska ngelur DeBeKa-ja!?(Shërbimi Sekret në gjuhën serbe-sqarim BM). Po këta i silli në maje të kalemit, po të gjithë këta janë tokmaka. Dakord, i thashë, dal nga dal të gjithë këta do të jenë në kabinetin tim.

Mendova se me kaq do të merre fund puna. Nuk shkuan disa ditë, më thonë që ka ardhur të më takojë njëfarë Haki Fejzuli! E pranova, më urdhëron që ta pranoh Haki Agushin dhe të kem kujdes se në çfarë posti do ta lë. Kiroja më thotë që ky farë Haki Fejzuli është ekspert në tredhjen e shqiptarëve nëpër stacione policore. Gjithandej ftohet ky kur duhet t'ua ha shpirtin shqiptarëve e t'i keqtrajtojë deri në vdekje. Pas këtij, një ditë më erdhi Hifzi Mehmeti, edhe ky njëfarë satrapi antishqiptar. Dikur më erdhi edhe Rauf Qazimi dhe më sugjerojnë që mos të habitem shumë në zyre por të dilja me ta më shpesh, si më parë, në gjueti. Po kur më erdhi dhe komandiri Zdravko Rafajllovski, nga Vollkova, të intervenojë për Sherif Deharin atëherë më plasi dhe nisa të kërcënohem edhe unë. I thashë Kiro Fuzofskit që, le të ndërpriten këto vizita se, ndryshe, do ta çoj në këmbë popullatën myslimane, do t'ju vë në pozitë shumë të rëndë. Do të flas e do të tregoj për të gjitha planet që i keni. E kam shumë të lehtë që ta radikalizoj masën myslimane dhe ta përmbys krejt shtetin. Pas këtij kërcënimi, Kiro Fuzofski më tha që, të shtrëngohem fort, nuk do ta kem të qetë këtë mandat, do të më lodhin deri sa të më detyrojnë që të vetëvritem..." (Memoari nr. 43).

Sulejman Rexhepi tregon se bashkëpunimin e vazhdoi edhe në rrafshin politik. "Unë dhe Kiroja jemi zbulues të shumë aferave dhe projekteve shqiptare. Ndryshe, nuk do të mund të rrija në postin e Kryetarit të BFI-së. Duhej të rrija në krye të këtij Institucioni dhe të isha bindës si lider kombëtar dhe përmes meje të qarkullonin shumë informata e projekte. Ndryshe, nuk do të më mbanin në atë pozicion as dy minuta. Shërbimeve sekrete nuk ju duhet lider i papërdorshëm. Këtë po e dëshmoj unë përmes këtyre memoareve dhe, po kështu, shumë vite para meje, këtë e ka dëshmuar edhe Nafi Çegrani, udbashi më i rreptë dhe, njëkohësisht, më i sinqertë shqiptar" (Memoari nr. 47).

(Vijon)

E rrallë

Karikuesi i telefonit i shpërthen në autobus

Një moment tronditës ka ndodhur në një autobus teksa karikuesi i telefonit i ka shpërthyer një të riu. Ngjarja ka ndodhur në Kinë dhe, fatmirësisht, askush nuk ka mbetur i lënduar. I riu ishte i ulur kur në një moment karikuesi, të cilin e kishte në çantë, shpërtheu duke krijuar një flakë të madhe.




FOTO E DITES



Një grua kalon një urë mbi një kanal në një komunë në Kamboxhia. /AFP/

E jashtëzakonshme

Polici e ndihmon burrin e moshuar për ta kaluar rrugën

Policët janë vërtet heronjtë e kësaj bote. Ndonjëherë veprimet e tyre janë aq shumë për t'u duartrokatur, si puna e një polici në Kinë. Pamjet amatore të publikuara në rrjetet sociale shfaqin burrin e moshuar, i cili me ndihmën e patericave mundohet të qëndrojë në këmbë dhe



ta kalojë rrugën derisa drita e gjelbër e semaforit ishte e ndezur, por polici i del në ndihmë e bartë në shpinë.

BARSOLETA E DITËS



Gjyshja: Çka po bon?
Nipi: Po këqyri qitu në 'Facebook'. Desha me të pyet diçka, po ti sigurisht nuk di.
Gjyshja: Çka ashtu?
Nipi: Mos e njuh këtë 'Bukuroshen e vogël'.
Gjyshja: Po, unë jam ajo.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 15:00

"AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlet Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo




Në ora 18:00

"ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

"DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

Regjia: David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.




Në ora 22:00

"I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Dashuria është ajo që ju ndjek gjatë gjithë ditës së sotme, por jeni ju që po tregoheni pak indiferent në këto çaste dhe nuk i kushtoni rëndësi.



DEMI

Javë e çuditshme që më shumë do të merrni me udhëtime se me punën tuaj rutinë. Nuk jeni mësuar me këto ritme dhe dita sot do t'ju lodhë.




BINJAKËT

Sot do të jeni shumë korrekt me takimet, gjë që nuk ndodh zakonisht me ju. Në mbrëmje do t'ju pëlqejë surpriza që ka përgatitur partneri.



GAFORRJA

Po mundoheni të vendosni rregull në një vend që ka pllakosur kaosi. Nuk do t'ia dilni dot mban të vetëm, kështu që kërkoni ndihmë.



LUANI

Duket sikur nuk po ju dëgjojnë dhe nuk po ju kuptojnë. Mbase është perceptimi juaj i gabuar, sepse do të keni rezultate shumë të shpejta.



VI RGJËR ESHA

Mendime të kundërta jua turbullojnë mendjen dhe nuk dini se nga të pozicionoheni. Është mirë ta dëgjoni zemrën ndonjëherë.



PESHORJA

Si në jetën në çift, ashtu edhe në familje, këtë periudhë do të dilni si persona që nuk kënaqeni kurrë. Thjesht doni të jeni i përkryer në detaje.



AKREPI

Intuita sot nuk do t'ju lë në baltë. Në shumë raste do të kishit gabuar, por sot do të jeni mjaft përpara vetëm falë indicies që keni.



SHIGJETARI

Pak interes për të komunikuar me njerëzit sot dhe dëshirë mjaft e madhe për të qenë më afër me natyrën dhe për aktivitetet sportive.



BRICJAPI

Sot do ta nisni ditën me këmben e mbarë dhe po kështu do ta përfundoni. Duhet t'i falënderoni vjet që janë në anën tuaj këtë ditë.



UJORI

Megjithëse këtë periudhë jeni të mbingarkuar, do të gjeni pak kohë për të kaluar në shoqëri të mirë. Miq të janë ata tek të cilët mbështeteni gjithmonë.



PESHQIT

Këtë ditë do të keni logjikë të ftohtë për marrjen e vendimeve, por do të jeni dhe mjaft të ndjeshëm karshi personave që ju duan.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SWITZERLAND - JAPAN

1

CROATIA - SENEGAL

1

POLAND - CHILE

1

'Dugi', afër Dukagjinit

Dugagjin Gashi është afër marrëveshjes me Dukagjinin e Klinës. Mesfushori është larguar pas shtatë vjetësh nga Drenica dhe synimi i tij është të luajë në ndonjë klub prej klubeve afër vendlindjes. "Kam kontakte me Dukagjinin e Klinës dhe me gjasë do të jam pjesë e kësaj skuadre për faktin se ka një projekt serioz për të hyrë në Superligë", ka deklaruar Gashi

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Dugagjin Gashi është një prej lojtarëve më të mirë në futbollin e Kosovës që nga paslufta, kurse pas shtatë vjetësh është larguar nga skuadra e Drenicës. Gashi të enjten për "Epokën e re" ka treguar edhe arsyen e largimit nga skuadra kuqezi, por ka bërë me dije se asnjëherë nuk do ta harrojë këtë skuadër. "Nga Drenica jam larguar vetëm për shkak të largësisë. Gjatë shtatë vjetëve kam udhëtuar çdo ditë, por jam krenar me këtë, sepse kanë qenë vite të mrekullueshme. Falënderoj nga zemra të gjithë Drenicën dhe i dëshiroj shumë suksese, pasi është një klub fantastik dhe asnjëri nuk do ta harrojë kohën e kaluar në të", ka thënë Gashi.

Më pas mesfushori ka thënë se e ardhmja e tij nuk do të jetë në Besën e Pejës, pasi askush nga ky klub nuk e ka kontaktuar. "Nuk kam asnjë marrëveshje me Besën e Pejës dhe mund ta konfirmoj se askush nuk më ka kontaktuar nga kjo skuadër", ka shtuar Gashi. Ish-futbollisti i Feronikelit ka treguar se synimi i tij është ta vazhdojë karrierën në një klub prej skuadrave nga Rrafshi i Dukagjinit, kurse me një klub prej tyre është shumë afër marrëveshjes. "Tash për tash jam lojtar i lirë, por besoj se shumë shpejt do të vendos për të ardhmen. Dëshira ime është të luajë për një klub prej skuadrave në Rrafsh të Dukagjinit për arsye që të jam më afër shtëpisë. Kam kontakte me Dukagjinin e Klinës dhe me gjasë do të jam pjesë e kësaj skuadre për faktin se ka një projekt serioz për të hyrë në Superligë", ka deklaruar Gashi.

Ish-reprezentuesi i Kosovës, përveç Feronikelit dhe Drenicës, ka luajtur edhe për Istogun, Vëllaznimin dhe Besën e Pejës.



Drita transferon Shalën

Skuadra kampione e Kosovës në futboll, Drita, pas transferimit të Betim Haxhimusës, e ka transferuar edhe mbrojtësin Arbër Shala, i cili ka bërë karrierë në futbollin e Shqipërisë. "Arbër Shala edhe zyrtarisht është lojtar i FC Dritës. Ai sot ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me klubin tonë. Mbrojtësi i krahut ishte pjesë e skuadrës së Laçit për dy sezone", thuhet në njoftimin e Dritës.

SHKURT

Donjeta Sadiku pëson humbje në çerekfinale

Boksieria nga Kosova, Donjeta Sadiku, ka pësuar humbje në çerekfinale të Kampionatit Evropian "Sofia 2018". Sadiku është mposhtur nga Rygielsa Aneta por, sipas Federatës së Boksit të Kosovës, meçi ishte i barabartë dhe se gjyqtarja ndikoi në vendimin final, pasi e ndëshkoi Donjetën me vërejtje publike. Kjo ishte paraqitja e parë në konkurrencën e senioreve për boksierin më të mirë nga Kosova.

Shaqiri, pasardhës i Marhezit në Leicester

Riyad Mahrez është synim i skuadrës së Manchester Cityt për afatin kalimtar të verës, kurse pasardhësi i tij në skuadrën e Leicester City mund të jetë shqiptari nga Zhegra e Gjilanit, Xherdan Shaqiri. Lajmi është bërë me dije nga "Telegraph". Reprerentuesi i Zvicrës, Xherdan Shaqiri, do të largohet nga Stoke City dhe Premierë Liga pritet të jetë sërish e ardhmja e tij.

Pajaziti largohet nga Drenica

Trajneri Sadat Pajaziti nuk do ta drejtojë Drenicën në edicionin e ri. Pajaziti kishte kontratë me skuadrën kuqezi edhe një vit, por kontrata është ndërprerë me marrëveshje të dyanshme. KF Drenica e ka falënderuar trajnerin Pajaziti për angazhimin dhe kontributin e dhënë për ekipin, duke i dëshiruar suksese në angazhimet e radhës.

Nadali në gjysmëfinale të French Openit

Rafael Nadal ka mposhtur Diego Schwartzmanin me rezultat 4-6, 6-3, 6-2 dhe 6-2, për të kaluar në gjysmëfinale të French Openit. Spanjoli nuk tregoi formë të mirë në setin e parë në të cilin Schwartzmann ishte më i mirë, por pasi ndeshja u ndërpre shkaku i shiut, në fushë u shfaq një Nadal më në formë dhe riktheu gjithçka. Nadal do të përballlet me Juan Martin del Potron që sot mposhti kroatin Marin Ciliq. Finalja zhvillohet të dielën.

Ambasadori hungarez kërkon përkrahjen e Kosovës

PRISHTINË, 7 QERSHOR - Ambasadori i Hungarisë në Kosovë, Laszlo Markusz, të enjten e ka vizituar Federatën e Hendbollit të Kosovës. Ambasadori Markusz është pritë nga presidenti i FHK-së, Eugen Saraçini. Vizita e ambasadorit Markusz kishte për qëllim thellimin e bashkëpunimit me FHK-

në që edhe deri më tani ishte në nivel të lartë. Në takim u diskutua sidomos për kërkesën e hungarezëve për FHK-në për t'iu ndihmuar në Kongresin e Federatës Evropiane të Hendbollit që mbahet këtë muaj në Glasgow të Skocisë. Hungaria dhe Sllovakia kanë shprehur interesim për ta organizuar kam-

pionatin evropian të vitit 2024 dhe për ta fituar organizimin e këtij evropiani. Hungarezët presin përkrahje edhe nga Kosova. Në takim është biseduar edhe për çështjen e vizave për sportistët e Kosovës. Si deri më tani, Hungaria ka premtuar përkrahje për FHK-në dhe hendbollistët e Kosovës.



Franca, kombëtarja më e shtrenjtë e Botërorit

PARIS, 7 QERSHOR - Franca është ekipi më i shtrenjtë që do të jetë pjesë e këtij Botërori. Sipas lajmit të publikuar nga e përditshmja franceze "L'Equipe", sipas vlerave të futbollistëve, dilet në përfundimin se "gjelat" vlejnë plot 1

miliard e 80 milionë euro, me një si Mbappe (120 milionë euro), po kaq edhe Griezmann. Ndjek ekipi i Spanjës, me një vlerë prej 1 miliard e 40 milionë eurosh. Pavarësisht se ka lojtarë si Neymari apo Coutinho, Brazili

mban vendin e tretë, me një diferencë të ndjeshme në krahasim me dy vendet e para. Pesë herë kampionët e Botës kushtojnë 950 milionë euro. Gjermania pozicionohet në vendin e katërt, me "Pancerat" që kapin shumën

e 885 milionë eurove, ndërsa në vendin e pestë Anglia, vlera e "Tre Luanëve" është 874 milionë euro. 10-shja e parë plotësohet me radhë nga Belgjika, Argjentina, Portugalia, Uruguai dhe Kroacia.



Kosova ngrihet 11 pozita në renditjen e FIFA-s, bie Shqipëria



PRISHTINË, 7 QERSHOR - Kombëtarja e Shqipërisë humbi dy pozicione në klasifikimin e përmuajshëm të FIFA-s. Humbjet me Kosovën dhe Ukrainën kanë ndikuar në humbjen e pikëve dhe zbritjen në klasifikim të Shqipërisë, që e sheh tashmë veten në vendin e 58, me 538 pikë, ndërkohë që muajin e mëparshëm ajo ishte e 56-a, me 549 pikë. Ajo që ka përfutur

shumë në klasifikimin e FIFA-s është pikërisht skuadra e Kosovës që, pas suksesit me kuqezinjtë, ka kapërcyer 11 shkallë në renditjen e FIFA-s, duke u pozicionuar në vendin e 141-të, me 197 pikë të grumbulluara. Për sa iu përket vendeve të para të këtij klasifikimi nuk ka ndryshime. Në vendin e parë qëndron skuadra kampione e botës, Gjermania, me 1 558 pikë, e

ndjekur nga Brazili në vendin e dytë dhe Belgjika në vendin e tretë.

Ndryshimi i vetëm në dhjetëshen e parë të renditjes së FIFA-s është shkëmbimi i vendeve në mes të Polonisë e Spanjës. Skuadra polake është ngjitur me dy pozicione në vendin e 8, ndërsa Spanja ka zbritur dy shkallë për t'u pozicionuar e 10-a.

Golden State, afër titullit në NBA

OAKLAND, 7 QERSHOR - Golden State në finalen e tretë të "play-off"-it ka fituar 110-102 ndaj Clevelandit në NBA, duke udhëhequr 3-0 serinë dhe titulli kampion për sezonin 2017-2018 tashmë mbetet një formalitet për skuadrën e Warriorsit. Kampionëve të Golden State u mjafton vetëm një fitore në katër takimet e mbetura për ta fituar titullin kampion, ndërsa për Clevelandin përmbysja duket një mision i pamundur. Kevin Durant në këtë ndeshje realizoi 43 pikë e 13 rebaunde, lider në fushë për skuadrën e Golden States, duke bërë diferencën në parket. Ai ishte magjik në parket, duke udhëhequr skuadrën drejt një fitoreje të rëndësishme, ndërkohë që edhe pesë lojtarë të tjerë të Warriorsit realizuan mbi 10 pikë (Curry 11 pikë). Miqtë përmbysën shifrat në pjesën e dytë, duke anuluar një avantazh prej 13 pikësh të Cavaliersit në të parën. Për Clevelandin nuk mjaftuan 33 pikët, 10 rebaunde e 11 asistime të LeBron Jamesit, që u përpoq ta



